



fs

SHËRBIMI PËRMBARIMOR

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË

Nr. 2720-17 Regj.
Nr. 38794 Prot.

QENDRA KOMBËTARE
E BIZNESIT
Nr. 17087 Prot.
Datë 11.12.2017

URDHËR
PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE

Drejtuar : Qendrës Kombëtare të Regjistrimit
adresa : tirane

Per d*i*jeni : Vladimir Ujkan Ozmaj i dtl. 19/03/1967 (Adr. L.5 F.GOZHDES, Kavaje)

Per d*i*jeni :Micro Credit Albania Sha
Adresa: Tirane

Pranë Shoqërisë "SHËRBIMI PËRMBARIMOR FS" shpk me kërkesë të palës kreditore është regjistruar çështja përmbarimore me numër 2720-17 Regj, me palë:

Kreditor - Micro Credit Albania Sha

Kredidhenes - BANKA RAIFFEISEN

Debitor: Micurin Ujkan Ozmaj i dtl. 23/04/1968

Dorezanes: Vladimir Ujkan Ozmaj i dtl. 19/03/1967

Objekti - Kthim shume

Për vënie në ekzekutim të titullit ekzekutiv Kontrate Kredie Bankare dt. 15/03/2007, së bashku me Urdhrin e Ekzekutimit Nr.Vendimi 64 datë 18/05/2009 të Gj.Rr.Gj. Kavaje. Pas kalimit në ekzekutim të detyrueshëm si edhe Lajmërimit për të Ekzekutuar Vullnetarisht detyrimin që përmban Urdhri i Ekzekutimit në referim të neneve 517 dhe 518 të K.Pr.Civile,

KONSTATOVA SE :

Debitori **Vladimir Ujkan Ozmaj i dtl. 19/03/1967**, ka marrë njoftimin e Lajmërimit për Ekzekutimin Vullnetar të Detyrimit dhe nuk i është përgjigjur respektimit të afatit dhe kërkesave të këtij lajmërimi.

Në këto kushte në referim të nenit 527 të K.Pr.Civile duhet të filloj ekzekutimin e detyrueshëm, duke vënë sekuestër mbi kreditë dhe sendet e luajtshme te debitorit në masën që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimit.

Përsa më sipër, në referim të neneve 31 pika (b), 32 pikat (c) dhe 46 (paragrafi i 1-rë) të Ligjit Nr. 10031, Datë 11.12.2008 "Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat".

URDHEROJ:

Vendosjen e sekuestros konservative :

1. Në kuotat/aktivet e palës: **Vladimir Ujkan Ozmaj i dtl. 19/03/1967** në BSBAL me Nipt:L71921506A dhe në kuotat që **Vladimir Ujkan Ozmaj i dtl. 19/03/1967** zotëron në Shoqëri të tjera të regjistruara pranë jush.

2. Aktivet dhe kuotat e mësipërme do të qendrojnë të sekuestruara deri në një urdhëresë të dytë nga ana e jonë.

3. Të njoftohemi dhe informohemi menjëherë në lidhje me procedurën e vënies së sekuestros nga ana juaj.

Lidhur sa më sipër, duke e konsideruar këtë urdhër të plotë dhe konform kërkesave të ligjit, Ju vë në dijeni se:

a) Personat që bëhen pengesë për zbatimin dhe realizimin e tij, do të përgjigjen sipas dispozitave që parashikon Kodi i Proçedurës Civile dhe Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.

Kundër detyrimit që përcakton ky urdhër, i cili është një veprim proçedural përmbarimor i referuar në K.Pr.Civile, palët mund të paraqesin ankim të veçantë para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

"Shërbimi Përmbarimor FS Shpk"
Përmbaruesi GJYQËSOR

